



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 060/01-3131924
Kaçanik, 13.12.2024

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e XII (dymbëdhjetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 24 dhjetor 2024 (e martë) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e XII (dymbëdhjetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 24.12.2024 do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendim për financimin e shpenzimeve të varrimit, për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e komunës së Kaçanikut;
3. Propozim Vendim për Aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2025 nga lista e përgjithshme e pronave komunale;
4. Propozim Vendimi për miratimin e Nismës për bashkëpunim ndër komunal me komunën Iznik në Bursa të Turqisë;
5. Propozim Vendimi për Arovimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2025;
6. Raport për zbatimin e Planit të Integritetit.;
7. Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për deponimin e mbeturinave të ndërtimit dhe mbeturinave të demolimit të objekteve ndërtimore (mbeturinat inerte).
8. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “MUJA” OP;
9. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “JLG CONSTRUCTION” SHPK;
10. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.P “X-PLAST”;
11. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “NTP GREN PRODUCT”;
12. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “XHEMILE VISHI.B.I”;
13. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.SH.T “LYPETENI”;
14. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik Fatmir Gashi B.I.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr.060/01-29425/24
Kaçanik, 29.11.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **XI (njëmbëdhjetë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 29.11 2024. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht kur u lexua regjistri ishin 25 anëtarë, në ndërkohë arriti anëtari, Betim Shala. Në mbledhje mungoj me arsye: Arlinda Rakoci-Raka. kështu që pjesëmarrjes të kësaj mbledhje janë 26 anëtarë.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Zahir Doda-DA, Suhad Dullovi- DBPZHR, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës: Bejtulla Dalloshi, Makfire Malsiu.

Mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj- zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, 25 janë prezentë për momentin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e XI (njëmbëdhjetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës, data 29.11.2024, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e I (parë) e Jashtëzakonshme e KK, të datës 22.10.2024;
2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e X (dhjetë) e Rregullt e KK, të datës 30.10.2024;
3. Propozim Vendim për caktimin e shkallëve tatimore progresive në pronën e paluajtshme për vitin 2025;
4. Propozim Vendim për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2025;
5. Diskutim për aktivitetet kundër dhunës në baza gjinore.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës

Aprovoj

Rendin e punës prej 5 pikave.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e I (parë) e Jashtëzakonshme e KK, të datës 22.10.2024;

Procesverbalin i mbledhjes se kaluar të KK u aprovua me 17 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenime nuk ka, ndërkaq nuk votuan anëtarët nga LVV pasi nuk kanë qenë pjesë e këtij procesi. Prezentë 25. Në sajë të kësaj del konstatimi së kuvendi i Komunës pa vërejtje e,

Aprovoj

Procesverbalin nga mbledhja e I (parë) e Jashtëzakonshme e KK, të datës 22.10.2024/ Lënda:

2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e X (dhjetë) e Rregullt e KK, të datës 30.10.2024;

Procesverbalin i mbledhjes se X të rregullt të Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri, me një gabim teknik të diskutimi i Agim Mani, në f.14 rënia e numrit të nxënësve nga viti 2017 duhet të jetë 1550 e jo si është shënuar 1350. Në sajë të kësaj del konstatimi së kuvendi i Komunës

Aprovoj

Procesverbalit nga mbledhja e X (dhjetë) e Rregullt e KK, të datës 30.10.2024/ Lënda: 01Nr. 060/01-27044/24.

Procesverbali do të publikohet i korrigjuar.

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Ardita Rrahmani: Shprehi ngushëllimet e mia për humbjen e jetës së vajzës së re në orët e hershme të mëngjesit, bashkë ndjejmë dhembje me familjen, miqtë, kolegët e saj, ndërsa iu bëjë apel për kujdes të shtuar në këtë kohë të dimrit.

Iu uroj të gjithë popullit shqiptar festat e nëntorit -ditën e flamurit, ditëlindjen e komandantit legjendar Adem Jashari, daljen e parë publike të UÇK dhe 30 vjetorin e vdekjes se heroit Ismail Raka, kujtojmë jetën dhe veprën e lënë si trashëgim për atdhe. Lavdi heronjve, dëshmorëve dhe martirëve të këtij vendi, nderim të pafund dhe përjetë veteranëve të UÇK.

Pyetjet:

1. Pas një takimi në shkollën fillore “Emin Duraku” me drejtoreshën e shkollës, përpos kërkesës për ndërtimin e shkollës amë, kërkesë kjo e kamotshme e gjithë neve, kur do të ndodhë ndërtimi i shkollës? Kërkoj të dijë, se a mundeni si komunë se paku me u bërë dezinfektimi me i shpeshtë në intervale kohore, për me parandaluar sëmundje, infeksion apo çdo gjë tjetër që ndikon në shëndetin e nxënësve dhe mësimmësuesve. Shpresoj dhe kërkoj me ngulm që kjo kërkesë do të merret parasysh. Të bëhet intervenim i menjëhershëm dhe i domosdoshëm duke ditur rrezikun që ka shkurtimi i ditës për fëmijët që përfundojnë mësimet në orët pasdites. Mungesa e ndriçimit publik në Begracë, është shqetësim i banorëve, sidomos i prindërve të nxënësve.
2. Banorët e f. Runjevë dhe Stagovë, ndajnë të njëjtin shqetësim për ndërtimin e rrugës së fshatrave, të cilat janë bërë në punimet e hekurudhës. Po ashtu banorët e f. Stagovë shprehin indinjatë për shpejtësinë që kamionët që kalojnë kalimthi, se po rrezikojnë jetën e fëmijëve që ecin në rrugën pa trotuar. Po e ri përsërisë po ashtu kërkesën e f. Runjevë për ndërhyrjen në urën e vjetër, me konkretisht të shkolla e fshatit.
3. A keni menduar në ndërhyrjen e pllakave betonit, të shkatërruara në rrugën “Ismail Qemali”?

znj. Kadrije Lika-Troni: Në mbledhjen e fundit, unë i kam bërë dy pyetje, ndërkaq nuk kam marrë përgjigje as nga DA as nga DSHMS. Për sot unë pata planifikuar një pyetje për të cilën drejtori i arsimit në Informatën e DA nuk e dha përgjigjen. Unë sot nuk e shoh të arsyeshme të bëjë sot pyetje, përderisa nuk epën përgjigje. Kryesues, a mundeni me na treguar si me vepruar në këtë rast, kur ngritën pyetje dhe nuk epën përgjigje që 1 muaj ditë? Kjo me të vërtetë është shumë, se kërkesat që i adresojmë këtu, janë pak a shumë të ndjeshme, kërkesat janë të qytetarëve. A është në rregull unë me i përsëritë pyetjet? Ju drejtova juve kryesues, se po ndërldhesh nganjëherë me përgjigjet.

Kryesuesi i Kuvendit: Po me akuzoni mua, por unë nuk kam të bëjë asgjë me përgjigjet, por sido që të jetë është obligimi i yni me u përgjigjur për pyetjet dhe kërkesat. Unë nuk kam diçka tjetër, por të përcjellë si shqetësim dhe vërejtje me u përgjigjur. Është mirë me i përsëritë pyetje dhe me shikuar se në cilat pyetje nuk keni marrë përgjigje, që ne të përcjellim si shqetësim dhe si vërejtje.

znj. Kadrije Lika-Troni:

1. Kam një pyetje për drejtorin e DA, në Komitetin për Politikë dhe Financa që kërkoja a është përmbushur numri i asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta? Përgjigja ishte, numri i paraparë është 11, ndërsa ju keni përmbushur vetëm 9 prej tyre. Kjo të bënë me kuptuar se janë 2 vende të lira. A mundeni të rekrutoni një asistentë për nxënësen në gjimnazin “Skënderbeu”, për të cilën jeni të njoftuar të gjithë?

2. Pyetja e drejtuar DSHMS: Në ligjëratën që u mbajt në ligjërimin e QKMF për barazi gjinore për tetorin rozë, ndër të tjera propozova që, QKMF ka nevojë për një psikologe e cila merret me sfidat e kancerit të gjirit. Kërkoj nga drejtoria të merr parasysh kërkesën time, të shqyrtoj mundësinë e një psikologu në QKMF. Këto ishin kërkesat për të cilat është dashur me pritur një muaj.

Për derisa banorët e f. Llanishtë presin të ngriti një pyetje, unë nuk mund të ngriti atë, pa më kthyer përgjigjet në pyetjet e mbledhjes së kaluar.

z. Naim Beça: Së pari iu uroj festën e flamurit të gjithë qytetarëve të Kaçanikut. Kryesues, e kam një vërejtje, se për çdo festë po harron me uruar festën. Dita e flamurit është ditë e krejt shqiptarisë, është mirë me na uruar, se ju jeni udhëheqës i joni.

Kryesuesi i Kuvendit: Dje kanë qenë aktivitetet, e kemi uruar njëri tjetrin, por sidoqoftë kërkoj falje, ju uroj tani.

z. Naim Beça: 1. Çështja e qenve endacak, është përmendur këtu sa herë. A është marrë ndonjë veprim në këtë drejtim, se qentë veç po shtohen? Ndriçimi publik në Kaçanik është shumë i varfër, nxënësit kur po shkojnë në shkollë, po kanë rrezik nga qentë endacak, ndërkaq janë 3,4 raste të grave dhe fëmijëve të sulmeve nga qentë endacak. A është marrë ndonjë veprim në këtë drejtim, se ne po e përmendim këtë çështje, ndërkaq nuk e di se është marrë ndonjë veprim në këtë drejtim ndonjëherë?

z. Agim Çaka: Shprehi ngushëllimet e mija, për vajzën që ka humbur jetën sot në aksident. Shfrytëzoj rastin t’iu uroj të gjithëve festat e nëntorit.

Pyetje:

1. Rruga ‘Idriz Seferi’, e cila është rrugë e re, është asfaltuar tani, mirëpo kjo rrugë sa e kemi pa, nuk i plotëson standardi të as një rruge, bile as të rrugës lokale, e lërë me rrugën kryesore që lidhë Kaçanikun si qytet me rrugën magjistrale. Në rrugë kam pa disa prerje që janë bërë, të cilat do ti potencoj. Ndriçimi publik ende nuk është lëshuar në funksion. Pjesa tjetër është një rrugë e ngushtë e cila nuk mundet me lidhur qytetin me magjistrale. Trotuari, se paku gjysma e rrugës nuk ka trotuar. Si ka mundësi që dikush që e përcjellë këtë projekt, nuk jep ndonjë

vërejtje të pjesa e trotuarit, që aty me pasur mundësi me kaluar se paku 1 qytetar. Aty janë vendosur shtyllat e ndriçimit. Këto punë që po i bënë dikush shkel e shko, e ka pa që nuk po interesohet kush, jo vetëm të ky projekt, jo vetëm me investime të komunës, por edhe me investime të nivelit qendror, projektet po realizohen me gabime të shumta. Është dashur me intervenuar të kjo rrugë, sepse nuk ka asnjë standard, ku aty mundet me na ndodhë shumë shpejtë ndonjë aksident, ashtu siç ndodhi sot.

z. Agim Mani: I kam 2 pyetje për kryetarin. 1. A mundeni me na informuar për gjendjen e projektit të rrugës: Runjevë-Stagovë? Ky projekt ka dal në tender në muajin qershor 2024, por ende nuk kanë filluar punimet. Cilat janë arsyet që kanë penguar nisjen e punimeve, dhe në cilën fazë gjenden punimet e kësaj rruge?

2. Lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, për të cilat kontratat i keni nënshkruar ju kryetar, kërkojmë t 'na sjelli raportin që të informohemi neve si përfaqësues të KK dhe qytetarëve për pronat e dhëna në shfrytëzim. Neni 22 paragrafi 2 i ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës, ju si kryetar e keni obligim të raportoni rregullisht në çdo 6 muaj në KK për monitorimin dhe e realizimit e kontratave dhe përmbushjen e kushteve të tyre. Mirëpo, u bënë 1 vit që nuk keni raportuar, edhe pse e keni obligim. Kërkoj t 'na jepni një përditësim të këtyre çështjeve dhe raporte të veçanta të këtyre kontratave.

Kryesuesi i Kuvendit: shfrytëzoj rastin që në emër të gjithë juve, t'iu përcjellë mesazhin familjes të ndjerës, me sinjeritetin me të madh. Në të njëjtën kohë iu përcjellë mesazhin për kujdes gjatë ngasjes së automjeteve.

3. Propozim Vendim për caktimin e shkallëve tatimore progresive në pronën e paluajtshme për vitin 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është këtu, materialin e keni marrë, ligji për tatimin në pronë ka ndryshuar, kështu drejtorja është dashur me harmonizuar Propozim Vendimin me ligjin e ri. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Në gusht të vitit 2023, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligjin për tatimin e pronës së paluajtshme. Në këtë ligj është futur koncepti profesional në shkallën tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme, i cili synon të adresoj çështjet e drejtësisë dhe barazisë gjinore. Ky ndryshim, është rezultat i një organizimi të debatit të gjatë nga niveli qendror, zbatimi i tij mbetet në përgjegjësi të nivelit lokal. Në të kaluarën, shkalla e tatimit ka pasur dallime në kapacitetet e pagesave dhe tatim paguesve, pasi që bizneset dhe individët paguajnë njëjtë, pavarësisht nivelit të ardhurave dhe nivelit të pronës. Në futjen progresive të TP është vendosur një standard, ata që kanë të ardhura me shumë, paguajnë me tepër, ndërsa e kundërta për ata që kanë të ardhura me pak. Ky është një parim në përputhje me parimet e drejtësisë sociale, dhe barazisë dhe kontribuon në ndërtimi e një sistemi të drejtë tatimor dhe efikas.

znj. Ardita Rrahmani: Unë e kam dhënë qëndrimin e LDK edhe në KPF, ne si LDK jemi kundër këtij ligji, e dimë që komunat janë të obliguara me punuar në harmoni me ligjin e ndryshuar, por ne si LDK jemi kundër ngritjes së taksave, se nuk përputhem me ide me atë që proklamohet me ligj.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne a pajtohemi apo jo, jemi të obliguar me respektuar ligjin. Ajo që ne duhet të diskutojmë, është se, brenda ligjit ka norma, për të cilat iu lihet kompetencë komunave për me lëvizur brenda atyre normave. Ne, për këtë çështje mund të diskutojmë, a po vendosim për norma me të larta apo me të ulëta. Ne duhet të shkojmë me normat minimale, sepse niveli

i zhvillimit ekonomik nuk është si vendet me të mëdha që kanë zhvillim me të madh, si Prishtina apo Ferizaj.

znj. Ardita Rrahmani: Ne e shprehëm qëndrimin tonë këtu, e shprehim edhe në votë, por kur të vjen koha me arsyetuar, e arsyetojmë. Edhe nivel qendror kemi shprehur mendimin tonë për këtë çështje, edhe në nivel lokal e shprehim.

z. Rrustem Zenuni: Sa i përket pikës që po trajtojmë, ne vazhdimisht e kemi shprehur se ne angazhohemi ne të mirë të qytetarëve për normat me të ulëta brenda ligjit të TP. Përkundër deklarimeve këtu, ne vazhdojmë t'i qëndrojmë besnik qytetarëve, se ne jemi duke punuar që të mbrojmë dhe mos të ngarkojmë qytetarin. Edhe në kohën kur ka pasur çrregullim të tregut, ka pasur inflacion, edhe tani, ne e dëshmojmë në praktikë mbështetjen për qytetarë, jo me deklarime siç po ndodhë qoftë në KK apo diku tjetër.

z. Agim Çaka: Sa i përket kësaj çështje, edhe në parim jam kundër ngritjes së tatimit në pronë në këto kohë të vështira. Megjithatë, duhet të jemi të vetëdijshëm se ligji është ligj, pavarësisht edhe nëse është i keq, duhet me u zbatua. Pyetje për drejtorin, A e keni shfrytëzuar maksimumin që normat tatimore me qenë sa me të ulëta për komunën tonë?

z. Bahri Selimi: Normat të cilat i kemi dërguar, janë minimale, bazuar në ndryshim plotësimin e ligjit të TP. Deri me tani, pronat bujqësore i kemi pasur me 0.15%, komerciale me 0.18%, tani janë 0.10. d.m.th. është shfrytëzuar ajo mundësia me ligj. Nëse flasim për ligjin, ligji nuk është i favorshëm, jo rastësisht edhe është pezulluar nga qeveria, deri në zbatim të vitit 2026. Në bazë të ligjit, të normat progresive, vetëm një kategori e tatim paguesve i lehtëson, ndërkaq 90% jo saktësisht, ua rritë TP. Shembull konkret, po e marrë vetën time, se neni 1 dhe 9 në bazë të vlerave të tatimit, për deri në vlerën 100 mijë euro, kemi me u tatuar 0.10, ndërkaq mbi këtë vlerë, ndërkaq mbi këtë vlerë 0.20. Unë në bazë të vlerës time tatimore personale, tashmë 0.20%. Ligji në përgjithësi është jo i favorshëm, ka pasur kundërshtime. Agim Mani tha se ka pasur konsultime publike, jo nuk ka pasur konsultime publike për ligjin e TP as në departamentin e TP e as nëpër komuna. E jona është me zbatuar, kemi shkuar në minimum, kemi hequr dorë nga disa të HVK që mundën me u realizuar. Një përgjigje që ua kemi kthyer juve nga mbledhja paraprake, është mirë të vlerësoni, të analizoni, se aty shumica e kuptojnë se ata që kanë me pak paguajnë me pak, por shumica, marrë parasysh komunën tonë, afër 3000 prona nuk taten fare, se nga 15 mijë euro që zbritet vlera e TP në vitet paraprake, tani zbritet për 30 mijë euro. Ne jemi për vendimet që merren në favor të qytetarëve, por komunat tona siç jemi ne, qeveria duhet gjetur alternativa tjera për me ia plotësuar buxhetin. Ne taksën e biznesit e kemi zero prej shumë viteve, se nuk e kemi aplikuar atë taksë. Komuna duhet me realizuar diqysh të hyra për me i realizuar buxhetin, se projektet nganjëherë varën nga të hyrat tona në favor të qytetarëve, por asnjëherë nga qeveri-qeveri, qeveria në kohëve të fundit nga 2021-2023 nuk është realizuar ndonjë projekt nga qeveria. Për vitin 2025, 2026, 2027 është proklamuar për investime të projekteve kapitale nga qeveria, por nuk besoj se kanë me u realizuar. Kjo d.m.th. përmes ministrisë të hiqen diku mjetet, por të jep mjetet diku tjetër, për një pavarësim social. Ju e vëreni migrimin e popullsisë nga komunat me të mëdha nga ato me të vogla.

z. Naim Beça: Sado që flisni këtu, unë kam me votuar për, por po e shoh se keni njëfarë mendimi negativ për qeverinë. Ligji është ligj, pavarësisht qysh është, këtu nuk diskutohet a është ligji i mirë apo i keq, ligjin e ka sjellë qeveria, pavarësisht a është i mirë apo jo ligji. Populli e ka votuar qeverinë. Këtu jemi duke diskutuar me vlerën minimale dhe maksimale të tatimit në pronë. Tani nuk është mirë nga kjo foltore të flasim për çështjet qeveritare. Ju e keni sjellë çështjen në KK, ne kemi me votuar, ndërkaq nuk kemi çka me diskutua për qeverinë. Ne

e kemi pasur në diskutim çështjen e lirimit të TP të qytetarëve nga 100 euro, por ju nuk jeni pajtuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse me keni dëgjuar kur diskutova unë, të gjithë tjerët u morën me ligjin, unë merrem me normën. Ata që kanë me paguar TP kanë me vlerësuar se a është ligji i mirë apo i keq. Unë thash se, jemi duke biseduar për normat e TP të paluajtshme. Mos të marrim shprehje që me dalë jashtë rendit të ditës, mos të sulmojmë qeverinë, sepse ne i kemi të gjithë përfaqësuesit tonë atje, dhe ata e kanë ngritur këtë shqetësim, qoftë nga GP, individ apo OJQ. Ne në KK debatojmë për temat të cilat jemi të thirrur me debatuar, në kuadër të këtij ligji është vlerësimi i pronës, e dimë qysh është rritur vlerësimi i pronës, por nuk janë tema që ne duhet diskutuar dhe vendosur nga ne, është një organ tjetër me i lartë, ndërkaq ne duhet t'i zbatojmë.

z. Naim Beça: Këtë mendim i kisha edhe unë, por ju e theksuat me bukur kryesues.

z. Bahri Selimi: Të HVK të cilat realizohen nga TP, destinohen për realizimin e projekteve kapitale. Ne si komunë kemi shumë nevojë për IK, kështu këto mjete duhet të zëvendësohen. Ne nuk jemi duke e kritikuar vetëm këtë qeveri, por edhe qeveritë tjera, kontratën kolektive në arsim, tani e kemi aktive, është dashur me mbuluar nga niveli qendror këtë shumë, por kjo barrë po iu bien komunave.

z. Agim Mani: Të caktimi i normave tatimore, drejtori e mori një shembull. Nuk e di a e dinë si bëhet përlllogaritja apo po donë me dezinformuar. E mori një shembull për vete për 103 mijë euro, deri 100 mijë euro tatohesh 10%, për 3 mijë euro tatohesh 20%. Deri në 500 mijë euro tatohesh 20%, mbi këtë shumë 30%. Nëse ke të hyra 100 mijë euro, tatohesh 10%, deri në 500 mijë 20%. Sa i përket faljes së TP, e kemi pasur rastin në vitin 2023 me ua falë TP nga 100 euro qytetarëve.

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket faljes së borgjeve, komuna nuk është kompetente për faljen e borgjeve, kjo çështje është kthyer edhe nga gjykata kushtetuese, se ka qenë vendim antikushtetues. Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës merren me çështjen qysh e kanë bërë ligjin, ndërsa ne e zbatojmë edhe nëse nuk pajtohemi. Por me dalë e me thënë se, ne jemi kanë me i falë borgjet dhe ju jo, kjo është gabim, se ne kemi thënë se nuk jemi kompetent. Të jemi të qartë në këtë drejtim, se nuk keni të drejtë me hedhur akuza të pabaza për një çështje që e ka kundërshtuar gjykata kushtetuese.

z. Selajdin Troni: Edhe unë po ndërlidhem të falja e borgjeve. E kemi analizuar këtë çështje, po e marrë shembull vetën time, mbi 40 euro i kam pasur TP. Kjo nuk me ishte falë mua, dhe ne e dimë mirë se mbi 90% e qytetarëve të komunës së Kaçanikut nuk e kanë shumën mbi 100 euro tatim në pronë, për me iu falë borgjet. Me këtë vlerë, nuk iu kishte falë borgji askujt pothuajse, vetëm atyre që e kanë tatimin mbi 100 euro, e që janë pak që e kanë tatimin në këtë shumë. Nga niveli qendror, është rritur TP mbi 100%, kështu që mos ia leni fajin komunës së Kaçanikut për çështjen e faljes së borgjeve.

znj. Ardita Rrahmani: Si LDK e kemi dhënë një qëndrim në nivel qendror. Në të njëjtën kohë, unë përfaqësoj njerëz, të cilat janë përkrahës dhe besoj në programin e LDK. Unë kur vijë me votuar këtu, iu jap llogari vetëm atyre njerëzve. Nuk ka të drejtë askush me ardhur e me thënë pse e ke votuar apo nuk e ke votuar çështjen e caktuar. Secili duhet me u kthyer nga vetja e me pa çka na kanë detyruar këtu, se shpesh vijmë këtu pa vullnet për disa pika, por është obligim i yni për me ardhur me ngritur dorën, qoftë për, kundër apo abstenim. E dyta, po e përsërisë pyetjet e mija drejtuar drejtorit në KPF, për një arsye, jo pse nuk i kam të qarta, se ishte shumë mirë një kërkesë e një qytetari që mbledhjet e KPF duhet me qenë publike, për arsye dikush tjetër në KPF flet diçka tjetër, ndërsa në KK flet krejt diçka tjetër. Drejtor, sa prona janë në komunën e Kaçanikut që tatohen me 0.50%? Sa prona janë në komunën e

Kaçanikut që tatóhen në vlerën 0.40%.? Janë normat me të ulëta të disa kategori, por në këtë kategori janë me të larta për vlerën mbi 5 milion.

z. Bahri Selimi: Sivjet i kemi 0.15 dhe 0.18. Nuk kemi sivjet, nuk ka sivjet 0.50%, këto janë prej vitit të ardhëm. E bëjmë analizën me shkrim, se tani nuk i kam të dhënat.

z. Rustem Zenuni: E patëm me patjetër me diskutuar, për çështjen e faljes së 100 euro, u cek edhe me herët se kjo ka qenë kundër ligjit. E potencoj edhe drejtori, sikur ne ti falim borgjet, shuma mbi 400 mijë euro. Po të na i kompensonte qeveria këto mjete, sigurisht edhe ne do të mbështetnim. E kam një pyetje apo shqetësim: Pse qeveria TVSH të cilët qytetarët paguajnë gjatë blerjeve të produkteve, nuk na i kthen në investime kapitale? Me shumë se bënë grupi i juaj kërkesa për IK, askush nuk bënë. Ju në njërin anë thoni ti falim nga 100 euro të TP, në anën tjetër qeveria nuk bien asgjë për Kaçanikun. Këta janë të kurdisur nga persona tjerë, e thonë atë që ua thonë me thënë. Unë edhe atëherë kam thënë, sikurse të falën atëherë TP nga 100 euro, i binte diku një sallë sporti në një shkollë me ndërtuar, ndërkaq ju na akuzoni pse nuk po realizohet projekte, ndërsa asnjëherë nuk thoni çka jemi duke bërë ne. Ky është problemi që po e hedhin fajin, ndërkaq nuk merrni përgjegjësi për atë që ju lodheni. Nuk kam çka ju bëjë, e di se nuk jeni vetvetja, por çka me bërë, por nuk ka me shkuar larg, e këto gjëra kanë me ndryshuar.

z. Naim Beça: Nuk është në rregull për problemet tua që i ke, me na thënë neve ashtu.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkoj të diskutoni për çështjen që është temë debati.

z. Kadri Krivenjeva: Kryesues sa herë po i favorizoni ata të LVV, ndërkaq të partisë tonë ua merrni fjalën.

z. Agim Mani: Kryesues, ju edhe vet e theksuat se nuk ka pasur mundësi me u realizuar falja e TP. Ne edhe atëherë edhe sot jemi bazuar në ligj i ndryshim plotësim ligjit të TP, i ndryshuar me 16 gusht 2023. Nëse tatim paguesi ka paguar TP të vitit 2023, shuma e paguar llogaritet si paradhënie e vitit vijues, neni 11 pika b, shuma e faljes së TP në pronat e paluajtshme për të gjithë tatimpaguesit deri në lartësinë e shumës, por jo me shumë se 100 euro vetëm për vitin 2023. E dyta, Vendimi për faljen e TP merret nga KK i çdo komune, me se largu 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk jemi ne me përcaktuar ligjin a është kushtetues apo jo, por për derisa ka pasur një reagim, ne nuk e kemi obligim me zbatuar atë ligj. Kur një ligj dërgohet në Gjykatën kushtetuese, ai ligji nuk është i plotfuqishëm, derisa të sa të jep mendimin GJK. Kompetencat vetanake të komunave sipas LVL, normat tatimore, falja e borgjeve nuk i përkasin nivelit lokal, janë kompetenca të nivelit qendror, këtë e ka thënë edhe gjykata kushtetuese. Ne duhet flasim për normat tatimore.

z. Naim Beça: Po flasim për normat tatimore, janë 2 vërejtje që po i shoh këtu. Tjetërsimi i personit nuk është në rregull, nënçmimi i opozitës, nënçmimi i dikujt që mendon ndryshe, nuk është në rregull. Ne jemi këtu të komunës së Kaçanikut dhe unë flas për këtë komunë. Vlerësimi i qeverive, ato janë nivel shtetëror, ne nuk kemi fuqi me i ndryshuar. Rustem, nuk të ka hije me thënë se këta janë të kurdisur, nuk jemi asnjë të kurdisur. Për këtë shprehje duhet me kërkuar falje publikisht, përndryshe të qesim në gjyq. Nuk mundesh me thënë mua jam i kurdisur. Prej kujt jam i kurdisur? Kjo nuk është në rregull. Edhe ju si udhëheqës duhet me kritikuar dhe me kërkuar falje, se ai është anëtar i PDK, se nuk është në rregull me na quajtur neve të kurdisur. Edhe unë mundem me u shprehur me lloj fjalësh, por nuk është në rregull. Jemi në kuvend, kuvendi është i shenjtë dhe duhet me pasur kujdes shprehjeve, pavarësisht se tjetri mendon ndryshe.

z. Bashkim Luma: Qysh në fillim desha me të falënderuar se i jepe kahe pikës, që me u fokusuar të normat e caktuara, mirëpo drejtori e bëri këtë debat të panevojshëm. Të vlerat, normat e tatimit në pronë, drejtori tha se disa komuna përfitojnë disa jo. Drejtori tha se komuna jonë shumë pak qytetarët kanë me paguar TP, në përqindje. Kjo po i bien se qytetarët po përfitojnë në këtë rast. Tjetër është se buxheti i komunës mundet me u dëmtuar, ndërkaq qytetarët po paguakan me pak TP, sesa në vitet e kaluara.

z. Agim Çaka: Kjo pikë ka të bëjë me një vendim që kemi me marrë ne, e që vendimi derivon nga ligji, sepse vendimin që e marrim ka të bëjë direkt me interesat e qytetarëve. Prandaj, nëse e marrim një vendim për rritje të tatimit, që faktikisht i bien ashtu, por që kushtëzohet nga vendimi paraprak i cili është në fuqi, qytetarët janë duke na dëgjuar, ata munden mos me ditur ligjin dhe procedurën sesi vjen deri të vendimin i cili bazohet në ligjin aktual. Ne, qytetarëve duhet me ua bërë me dije, se jemi duke marrë një vendim, i cili sipas gjasave e rritë vlerën e tatimit, i cili vendim merret në bazë të ligjit në fuqi. Nëse ligji thotë që koeficienti duhet rritur fjala vjen nga 1-10, ne duhet shkuar në minimum të vlerës tatimore. Qytetarët duhet me ua bërë me dije se e kemi shfrytëzuar maksimumin për me iu ngarkuar në minimum sipas ligjit në fuqi. Ligji, a është i mirë apo i keq, është në fuqi dhe duhet të zbatohet.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne jemi duke folur për normat të cilat i ka caktuar ligji, nga këtë norma rrjedh edhe vlerësimi i pronës, se ka pas filluar vlerësimi i pronës në Prishtinë, por pastaj stagnoj, se u rritë shumë kostoja, edhe qysh ka qenë, nuk ka qenë mirë, por duhet me gjetur një mes, se nëse TP deri 100 mijë euro nuk tatohet, por kur të rritet vlera e pronës, se është rritur standardi, por deri sa të filloj me u zbatuar, nuk mund të kemi pasqyrë me të saktë, se pa u bërë rivlerësimi i pronave nuk e di, se nuk mundet me u vlerësuar njëjtë një vilë në Strazhë me një shtëpi. Andaj kur të kemi rivlerësimin e pronave, atëherë e shohim se ku jemi me taksa dhe tatime. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjti u aprovua me 23 votë Për, Kundër ishin 3 anëtarë nga LDK (Ardita Rrahmani, Betim Shala, Arlinda Rakoci-Raka). Abstenime nuk ka. Prezentë 26. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për caktimin e shkallëve tatimore progresive në pronën e paluajtshme për vitin 2025/Lënda/ 01Nr. 060/01-28018/24/Lënda.

4. Propozim Vendim për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: Siç e dini, në çdo fund vit e formojmë një komision për hartimin e Planit të punës së KK. E hapi diskutimin: Nëse nuk ka kush diçka, shkojmë me propozime konkrete:

z. Rustem Zenuni: Nga PDK e propozojmë për anëtar të jetë, Fatmir Bunjaku.

znj. Kadrije Lika-Troni: Nga LVV e propozojmë për anëtar të jetë, Agim Mani.

znj. Ardita Rrahmani: Nga LDK, e propozojmë për anëtar të jetë, Arlinda Rakoci-Raka.

znj. Edona Luzha: Nga AAK e propozojmë, për anëtar të jetë, Ekrem Livoreka.

Kryesuesi i Kuvendit: Nga NISMA e propozoj për anëtar të jetë, Agim Çaka.

Përpos këtyre emrave, në komision është i caktuar, Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, kryesues i komisionit dhe me nr. 7 është Makfire Malsiu-Zyrtare e KK.

Propozimet që dolën u shtruan në votim për aprovim dhe të njëjtat me shumicën e votave për, 24 votë, Kundër ishte Betim Shala, Abstenoj Raif Kasa. Prezentë 26. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

Vendim

Për formimin e Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025, në përbërje prej 7 anëtarëve, 6 anëtarë do të jenë nga Kuvendi i Komunës dhe 1 anëtar nga Zyra e Kryetarit të Komunës, si vijon:

1.1.Kemal Murseli,	kryesues	KK
1.2.Fatmir Bunjaku	anëtar	KK
1.3.Agim Mani	anëtar	KK
1.4.Arlinda Rakoci-Raka	anëtar	KK
1.5.Ekrem Livoreka	anëtar	KK
1.6.Agim Çaka	anëtar	KK
1.7.Makfire Malsiu	anëtar	Zyra e Kryetarit/ Lënda:
01Nr. 60/01-29265/24.		

5. Diskutim për aktivitetet kundër dhunës në baza gjinore;

Kryesuesi i Kuvendit: A ka të interesuar me marrë fjalën për këtë temë?

znj. Kadrije Lika-Troni: Sot si pjesë e fushatës 16 ditë aktivizëm kundër dhunës në baza gjinore, jemi këtu për të reflektuar për përgjegjësitë që kemi si shoqëri dhe si individ. Dhuna në bazë gjinore mbetet një plagë e rëndë për shoqërinë tonë, e cila prekë me së tepërmi gratë dhe vajzat. Shkaqet e dhunës janë të rrënjosura në pabarazinë gjinore, andaj dhuna përkufizohet si akt që shkakton dëm fizik, psikologjik, emocional. Shumë gra vuajnë në heshtje të izoluar nga frika dhe mbajnë mbi supe barrën e dhimbjes dhe shpesh nuk kanë dalë me pranuar dhunën si një fat të pashmangshëm. Është detyrë e jona t'iu japim atyre një zë, një dorë mbështetëse dhe një shpresë për një të ardhme me të mirë. Ne si shoqëri duhet të flasim hapur për dhunën, të mbështesim viktimat dhe të mos heshtim përballë padrejtësisë. Edukimi i brezave të rijë për barazi gjinore dhe respektin, është themelore për të ndërtuar një shoqëri të drejtë dhe të barabartë. Në nivel qendror janë marrë hapa, si miratimi i ligjeve për mbrojtjen e viktimave, dhe mekanizmave për raportin dhe ndihmë si dhe programe ndërgjegjësuara. Ndërsa në komunë ende kemi boshllëqe, prandaj nuk mundesh pa e theksuar mungesën e përfaqësimit gjinor në zyrën për Barazi Gjinore, kërkesë të cilën e kam ngritur disa herë gjatë këtij mandati. Aty nuk ka përfaqësim gjinor-gra dhe kjo e bënë të vështirë adresimin e sfidave që prekin me së shumti gratë. Ndërtimi i një strehimore lokale në komunën tonë, është kjo kërkesë që sot e bëjë për të dytën herë. Gjithashtu për me siguruar që viktima të ketë mbështetje secila viktimë e dhunës që gjendet në strehimore, të ndihmohet me nga 100 euro. Kështu thirrjet për vetëdijesim dhe jo heshtje, nuk do t'i ndalim çdo ditë të vitit secili prej neve. Për me tepër, vetëdijesimi i kësaj teme nuk duhet të neglizhohet nga institucionet komunale. Vendimi i ministres së Arsimit për të trajtuar temën e dhunës në bazë gjinore në orën e parë të mësimit me datën 25 nëntor, nxënësit e klasave 6 dhe 9 , 10 dhe 12, ishte një hap i rëndësishëm, por është për të ardhur keq që institucionet tona arsimore nuk e kanë përfillur këtë vendim. Kështu që kur flasim sot për moton dhe çdo ditë tjetër, ne duhet të ndërgjegjësojmë, të mbështetim dhe të qëndrojmë kundër dhunës. Duhet të jeni dritë për ata që janë në errësirë, e jo të neglizhojmë vendimet e jo t'i neglizhojmë vendimet dhe fushatat senzibilizuese.

znj. Ardita Rrahmani: Evoluimi i shoqërisë ndër vite, patjetër që sjellë lëvizje edhe brenda qyteteve, dhe jo vetëm. Lëvizjet e bëra, padyshim se sjellin lloj mendësisë, e rezultat i kësaj mendësie janë përfitimet dhe pasojat me të cilat njerëzit janë të detyruar të jetojnë dhe veprojnë. Mendësia e të qenurit superior ndaj një qenie tjetër, e që me e shpeshta sot është qenia grua, përbënë shkeljet me të shpeshta të drejtave të njeriut. Dhuna nuk njeh kufijtë social, ekonomik apo kombëtar. Prandaj, sot përmes kësaj foltoreje, shfrytëzoj hapësirën time, ku kërkoj që para veprimt të vjen thellësia e mendimit kritik. Ju bëjë thirrje institucioneve komunale për

shfrytëzimin e mekanizmave të saj në përkrahje të e viktimave të dhunës në bazë gjinore, në komunën e Kaçanikut.

znj. Lirije Dema: Dhuna ndaj grave dhe vajzave është një ndër shkeljet me të shpeshta të drejtave të njeriut në botë sot, nuk njeh kufij social, ekonomik, apo kombëtar. Në mbarë botën rreth 1/3 e grave përjetojnë një abuzim fizik apo seksual prej saj. Dhuna në bazë gjinore, dëmton shëndetin, dinjitetin, sigurinë dhe autonominë e saj. Ndërkohë mbetet e fshehur në një kulturë heshtjeje. Justifikimi, ai që të rrenë se të donë, thjeshtë nuk ekziston. Nëse dashuria do të shprehej nëpërmjet të dhunës, atëherë bota do të ishte një bombë me zile. Kur përmendim dhunën, mendja na shkon tek femrat dhe të gjitha vuajtjet që ajo përjeton. Nuk ndodhë shpesh të dëgjojmë për dhunën ndaj meshkujve, është femra ajo që nënshtrohet, dhunohet e tregohet mungesë respekti ndaj saj, sepse ajo delikatesë që e karakterizon, nuk zgjedhë asgjë me dhunë, për hir të familjes dhe ruajtjes së saj, është e gatshme të sakrifikoj e të vuaj në heshtje. Është pikërisht kjo heshtje, ajo që e bënë mashkullin të ndihet me superior dhe të vazhdoj të përdor dhunë fizike të saj. Turpi, frika dhe nderi, bëjnë që gratë të tolerojnë sjelljet e meshkujve. Gratë e dhunuara janë gjykuar e përgojuar nga shoqëria, në vend se të gjejnë mbështetje prej tyre. Meshkujt do të thonë se e meritonte, ndërsa gratë do të thonë se nuk do të ishte e aftë për detyrat që i takojnë si grua.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne të gjithë jemi mbështetës dhe përkrahës të aktiviteteve që merren në kuadër të kësaj teme që po e diskutojmë sot. Në këtë fushë, shoqëria jonë ka evoluar në këtë fushë me hapa pozitiv, pasur parasysh se ne kemi evoluar nga një sistem ku këto çështje kanë qenë tabu me i diskutuar e lerë me marrë aktivitete dhe veprime për parandalimin e këtyre dukurive negative. Si do që të jetë, ndoshta na ka ndihmuar në këtë drejtim edhe faktori ndërkombëtar që ka qenë i instaluar këtu për një kohë, dhe kemi ecur me hapa të shpejtë në këtë drejtim dhe sot gratë nuk janë në nivelin e kënaqshëm ku duam ne të gjithë t'i shohim, megjithatë ka përparim të jashtëzakonshme në këtë drejtim, mendoj se edhe për një kohë se në një të ardhme të shkurtër, këto çështje kanë me qenë jo të eliminuara se edhe në botën demokratike, këto çështje janë të dukshme, por sido që të jetë, nuk kanë me qenë në një stad të ultë, sepse shoqëria janë kanë staf, kanë kapacitete për të zhvilluar këtë vend dhe me u marrë edhe me çështje të barazisë gjinore, të cilat e prekin secilin familje apo individ.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Meqenëse është temë e debatit për KK, edhe ne si ekzekutiv nuk mundem pa u bërë pjesë e grupit. Unë si kryetar se bashku me ekzekutivin solidarizohemi me temën aktivitetet kundër dhunës në baza gjinore, se është temë që duhet diskutohet edhe me gjatë, e të jetë temë diskutimi, e jo vetëm në muajin nëntor. Ajo që mu duk e paarsyeshme, të kjo temë, gjuha që po përdoret, se po e trajtojmë krejt ndryshe dhunën në baza gjinore. Kadrija e përmendi se nuk pajtohem, nuk është që pajtohem as unë, por janë rregullat që përzgjidhen anëtarët për barazi gjinore. Ka qenë një femër, është tërhequr dhe zëvendësuar. Sikur fjala vjen e kemi një presidente femër, dhe paska diskriminim gjinor pse nuk është një femër, gjë që ajo është rotacion që vjen me kohë. Zyrtari për barazi gjinore i kryen punët si duhet dhe nuk mendoj se iu ka mohuar askujt e drejta për me punuar apo vepruar për me zhvilluar aktivitete në këtë drejtim. Sa i përket strehimoreve, ne e dimë që strehimoret nuk janë duke mundur me funksionuar, ne si komunë e Kaçanikut jemi bërë solidar, ashtu që kemi rritur shumë për 300% nga ajo që ka qenë në vitin e kaluar, për strehimore në nivel regjional. Pjesën tjetër, ne duhet të bëjmë bashkërisht, unë jam i mendimit që me ndihmuar në çdo aspekt që është e mundur. Nga shifrat zyrtare, nuk besoj se janë reale, thuhet se nga viti i kaluar dhuna në baza gjinore është në rënie e sipër. Kjo mund të jetë për mos lajmërimin e rasteve apo diçka tjetër, megjithatë qoftë edhe një rast i vetëm, ne duhet të luftojmë bashkërisht pozitivë e opozitivë pa ndasi, pa etiketuar njëri tjetrin për paaftësitë e njëri tjetrit apo diçka tjetër. Unë mendoj se

nëse niveli qendror funksionon mirë, nuk ka mundësi mos me funksionuar mirë në këtë drejtim, kështu që bashkë t'i marrim përgjegjësitë, në nivel qendror dhe lokal, për me arritur qëllimin që e kemi të përbashkët, që sa me pak me pasur dhënë në familje të çfarëdo natyre.

znj. Kadrije Lika-Troni: për derisa vendimi është zbatuar në nivel qendror, është në obligim edhe në nivel lokal. Unë mirë e ceka që, vendimi i ministres ishte, që ora e parë e mësimit të mbahet këtë temë, duke ia dedikuar këtë temë të debatit se bashku me nxënës. Unë mendoj që nga aty, ministra e ka paraparë së shumica e fëmijëve janë pjesë e dhunës në familje, dhe raportimi dhe çdo gjë që mos të heshtet, tregon shumë për me parandaluar këtë dhunë. Pse nuk është zbatuar vendimi, i cili është dërguar në të gjitha institucionet, nëpër të gjitha drejtoritë e arsimit, ndërsa në shkollat tona nuk është mbajtur një orë e tillë? A jeni të njoftuar për këtë çështje?

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Nuk po hyjnë në atë temë, por sikur të ishte ajo ministre me komunikues me komunën e Kaçanikut, do t'i kishim punët më mirë. Ne nëpër shkolla i kemi psikologët dhe pedagogët që raportojnë për gjithçka. Ata e dinë a është e arsyeshme kur duhet mbajtur dhe si trajtohen ata fëmijë që mbajnë ligjërata. Nuk mundet askush me na diktuar neve me mirë se sa ne që e kemi gjendjen këtu. Për atë e theksova, se po të ishte komunikimi me i mirë, do të ishte shumë me ndryshe, kështu që në rregull jemi.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kryetar mos dil jashtë temë, fokusoj në temën që jemi duke diskutuar.

znj. Ernesta Krasniqi: Në çdo shkollë në Kosovë janë mbajtur ligjërata të tilla.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: A keni përcjellë ju që në çdo shkollë janë mbajtur ligjërata të tilla? Qysh po e dini ju a janë mbajtur ligjërata në krejt shkollat në Kosovë?

znj. Ernesta Krasniqi: Me 25 nëntor, ora e parë është mbajtur në shumicën e shkollave është mbajtur ligjërata 16 ditë aktivizëm për dhunën në baza gjinore. Pse komuna jonë nuk e ka mbajtur? A ka ardhur lajmi prej ministrie për me mbajtur orën e parë. A ka shkuar drejtori i Arsimit në shkolla në këtë ditë?

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Ne nuk e mohojmë atë, qysh po e din se është mbajtur në krejt shkollat. Vetëm në Kaçanik është kuptuar që nuk është mbajtur. Atë nuk e mohuam ne, por është çështje e jona, nuk po dua të iu përgjigjem në këtë pyetje.

znj. Ernesta Krasniqi: Na jep përgjigje në pyetjen, Pse nuk është mbajtur ora e parë në shkolla me temë e caktuar. Nëse nuk përgjigjesh, çdo gjë tjetër që diskuton, nuk iu dëgjoj.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Me pas pasur obligim ligjor e kishim zbatua. Ku e keni pa ju që është në obligim ligjor kjo temë në shkolla?

Kryesuesi i Kuvendit: Me pas qenë obligim ligjor, sigurisht se ishte zbatuar. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës debatoj për temën: **Diskutim për aktivitetet kundër dhunës në baza gjinore.**

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:12. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarët e KK që ishin pjesëmarrës në këtë mbledhje.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK

Dati: 06.12.2024	Vendi: Kaçanik
Numri: 01-060/01-30804/24	Shënim:



Kuvendi i Komunës
Opština Kaçanik
